



**Sokol Muça**, (1970), ka përfunduar studimet master (LLM) në Universitetin Temple në Filadelfia/ShBA dhe studimet master (MCR) në Universitetin e Friburg-ut (Fribourg) në Zvicër.

Në Shqipëri ka përfunduar studimet për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës si edhe në Fakultetin Histori – Filologji në Universitetin e Tiranës.

Ka mbajtur një sërë pozicionesh si:

- Këshilltar për Projektet, Inovacionin dhe Teknologjinë në Ministrinë e Kulturës;
- Këshilltar për Inovacionin, Teknologjinë dhe të Drejtat e Fëmijëve në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve;
- Drejtor i Programit Akademik në Microsoft;
- Drejtor Shërbimesh Mbështetëse dhe Projektesh Ligjore në organizata ndërkombëtare dhe shqiptare;
- Drejtor Projektesh në shoqëri të rëndësishme tregtare private ndërkombëtare dhe shqiptare;
- Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë;
- Ekspert për organizata të ndryshme vendase dhe ndërkombëtare, etj.

Ka marrë medaljen “Gallantry Award” në Britaninë e Madhe me motivacion: “Në njohje të shërbimeve të çmuara për fëmijët, për faktin se gjatë gjithë periudhës së krizës kosovare ka shpalosur kurajë dhe durim për të bërë të mundur që të realizoheshin programet më efektive të mundshme për fëmijët, të cilët u prekën më shumë gjatë asaj lufte” dhe Medaljen “Pishtar i Demokracisë” nga Presidenti i Republikës me motivacionin: “Për kontributin e veçantë në përkrahje të proceseve demokratike dhe përmbysjes së regjimit komunist” në Shqipëri.